



Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë

OZHQ-të: Agjenda jonë më e guximshme për njerëzimin

Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm përcakton një vizion gjithëpërfshirës dhe një plan universal për t'i dhënë fund varfërisë së skajshme, pabarazisë dhe ndryshimeve klimatike deri në vitin 2030. Duke premtuar të mos lëmë askënd pas, Agjenda 2030 është agjenda jonë më e guximshme për njerëzimin.



17 Qëllimet Globale promovojnë të drejtat e njeriut, qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe i përkasin çdo institucioni, vendi e personi. Kosova është e përkushtuar për arritjen e OZHQ-ve dhe ka kontribuar shumë në vendosjen e kësaj agjende të re globale. Përkushtimi i saj ndaj OZHQ-ve filloi me konsultime të gjera publike nga viti 2012 deri në vitin 2015 dhe kulmoi në janar 2018, me miratimin zyrtar nga Kuvendi i Kosovës të një Rezolutive për OZHQ-të, duke shprehur përkushtim të fuqishëm për përdorimin e OZHQ-ve dhe kornizës së tyre zhvillimore.

"Ne duam t'i shohim kosovarët të jetojnë një të ardhme në të cilën fëmijët e tyre të mund të kenë ajër të pastër, arsim të mirë dhe punë të denjë në Kosovë"

- Koordinatori për Zhvillim i OKB-së Andrew Russel



Punojmë së bashku për Agjendën Globale

Gjatë vitit 2017, agjencitë e OKB-së, OJQ të ndryshme dhe subjektet e sektorit privat bashkëpunuan në mënyrë aktive për të arritur vizionin global të OZHQ-ve përmes një sërë aktiviteteve të avokimit që përfshinë popullsinë e Kosovës. Ndër iniciativat e ndryshme, më të shquarat ishin:



Çmimi i Gazetarisë për Varfërinë, organizuar nga Ekipi i OKB-së në Kosovës dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Veprimtaria synonte shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Çrrënjësjen e Varfërisë, duke vlerësuar punën e gazetarëve që mbulojnë çështjet e uljes së varfërisë në Kosovë. Këtë vit, artistja kosovare me qëndrim në Mbretërinë e Bashkuar Alketa Xhafa-Mripa solli një tribut të veçantë për çmimin, duke krijuar një instalim arti që prezantoi një seri fotografish bardh e zi që portretizojnë tregimet e varfërisë dhe përjashtimit social.



Iniciativa e Avokimit për Ndryshime Shoqërore "Podiumi për OZHQ-të", përmes fazës së komunikimit u mundësoi qindra vajzave dhe djemve nga komunat e ndryshme në Kosovë që të mësojnë rreth Agjendës 2030, dhe përmes punëtorive të dedikuara u mësoi mbi dyzet të rinjve si të identifikojnë nevojat e komunitetit, si të punojnë së bashku me bashkëmoshatarët, dhe si të avokojnë për prioritetet e komuniteteve të tyre. Në universitetet publike të Prizrenit dhe të Pejës, UNDP-ja paraqiti legjislacionin kyç për të drejtat e njeriut (ligji për gjininë, ligji për trashëgiminë, e drejta familjare dhe të gjitha ligjet të përfshirjes gjinore) për t'u mundësuar studentëve të kuptuarit më të thellë të të drejtave të tyre dhe të procesit të realizimit të tyre.



Edhe pse korniza ligjore e Kosovës bën thirrje për barazi të plotë për burrat dhe gratë, diskriminimi ndaj grave ende vazhdon, duke rezultuar në mbrojtjen e papërshtatshme të disa të drejtave themelore të njeriut të garantuara me ligj. Fushata 16 Ditë të Aktivizimit kundër Dhunës ndaj Grave filloi në vitin 2013, dhe prej atëherë është rritur numri i ngjarjeve dhe efekti i saj në terren. Në vitin 2017, agjencitë e OKB-së, të udhëhequr nga UNWOMEN, bashkëpunuan me OJQ të Kosovës (si Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës), me Kuvendin e Kosovës, organizatat ndërkombëtare si OSBE, EULEX, UNMIK, KFOR dhe të tjera, dhe u zhvilluan më shumë se 77 ngjarje të ndara në të gjithë Kosovën për të avokuar kundër çdo lloj forme të dhunës ndaj grave dhe kundër pabarazisë gjinore. Një nga ngjarjet më të suksesshme ishte shfaqja e baletit "Një Ditë", nga Baleti i Teatrit të Kosovës.

Hartimi i politikave në përputhje me OZHQ-të

Me miratimin e Rezolutës për OZHQ-të, Kosova vazhdon t'i integrojë objektivat në procesin e saj të planifikimit strategjik për të arritur parakushtet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 dhe Plani i Përbashkët për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PPZH) 2016-2020 janë dy programe të veçanta, të cilat janë duke u përafuar edhe më shumë përmes integrimit me njëri tjetrin, me caqe dhe tregues të veçantë që do të maten për progres gjatë viteve të ardhshme.

Si SKZH-ja ashtu edhe PPZH-ja përqendrohen dhe kanë integruar OZHQ-të 1,2, 4, 5, 8, 10, 12 dhe 15 në një sferë të përbashkët.

"Si rrugë të përparimit, ne do të shfrytëzojmë burimet ekzistuese, sidomos ato që mundësojnë koordinim dhe harmonizim më të mirë mes Agjendës Evropiane dhe Agjendës 2030"

- Kryeministri Isa Mustafa



"Asnjëri prej nesh nuk mund të veproj i vetëm"

- Drejtori i Misionit të USAID-it, James Hope

Një tjetër sfidë e rëndësishme që duhet trajtuar është OZHQ 13, Veprimi Klimatik, që lidhet me çështjen e ndryshimeve klimatike dhe ndotjes së mjedisit. Prishtina dhe qytete të tjera në Kosovë vuajnë nga ndotja e rëndë e ajrit dhe kohët e fundit qeveria ka miratuar një rezolutë për ta trajtuar këtë çështje, duke ndërmarrë hapin e parë drejt lokalizimit të OZHQ-ve në kuadër të politikave të brendshme.

Të dhënat statistikore për OZHQ-të

Progresin e OZHQ-ve në Kosovë mund t'a tregojmë përmes të dhënave statistikore. Të dhëna të besueshme grumbullohen nga institucionet, shoqëria civile dhe akterë të tjerë. Lista e treguesve të synuar dhe indikatorëve mund të shihet këtu: <http://unkt.org/sdg/>

Për me shume rreth Agjendës 2030 të OZHQ-ve lexoni këtu: <http://unkt.org/sustainable-development-goals-2/>

